



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



QKMF "ADEM UKËHAXHAJ" DEÇAN

Nr.135/03

Dt.31.03.2023

QKMF "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan, në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës të RK NR.03/L-212, Udhëzimit Administrativ të MPMS nr.07/2017, Vendimit NR.134/03 dhe Këshillit Drejtues të dt.28.03.2023 , publikon këtë:

KONKURS-SHPALLJE PUBLIKE

Më anën e se cilës publikojmë tetë (8) vendpunime, për tre (3) Doktor të mjekësisë ose Specialist i Mjekësisë Familjare , një (1)Doktor të Stomatologjisë,një (1) teknik të radiologjis dhe tre (3) infermier ,të gjithë në kohë të pacaktuar.

Kushtet

Kandidatët-tet, kushtet e mëposhtme për punësim i dëshmon duke ia bashkangjitur kërkesës për punësim dokumentët:

Për Doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjis dhe infermier e teknik të radiologjisë

- 1.Diplomën e fakultetit të mjekësisë dhe licencën e mjekut (origjinalin ose të noterizuara)
- 2.Diplonën Bachelor ose të shkolës së mesme të mjekësis për infermier dhe teknik të radiologjisë. (origjinalin ose të noterizuara)
- 3.Kopjen e Leternjoftimin ose Certifikatën e lindjes;
- 4.Certifikatën mjeksore, si dëshmi mbi aftësitë psikofizike për punësim dhe
- 5.Dëshmi nga zyra për punësim qe sjeni në marrëdhënie pune.

Numri i pozitave: kater (4)

Lloji i Pozitës(3) doktor i mjekësis dhe (1) doktr i stomatologjisë

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i QKMF;

Grada/Koeficienti:H 10 – 7.4 për spec.MF H8- 12

Kohëzgjatja e kontratës: Në kohë të pacaktuar;

Periudha e punës provuese: Gjashtë (6) muaj.

Orët e punës: 40 në javë

Detyrat dhe përgjegjësit e doktorit të mjekësis

Pranon pacientin nga infermierja,shënon të dhënat e duhura në kartelën shëndetësore.

Merrë anamnezën, bën inspektimin ,auskultimin dhe palpacionin e pacientit,bën reanimimin kardio pulmonar,ekzaminimin e shpinës dhe ekstremiteteve,ekzaminimin rektal,referon pacientin për hulumtime të duhura,cakton diagnozën,trajton pacientin me terapi adekuate,bën edukimin dhe promovimin shëndetësorë,këshillon pacientin,cakton terminin e vizitës së ardhshme,organizon dhe mbikëqyrë imunizimin,cakton vizita konsultative ,kujdeset për paisjet e punës.

Bënë edhe punë tjera nga profesioni i vet .Për punën e vet i përgjigjet Drejtorit të QKMF-së.

Detyrat dhe përgjegjësit e Doktorit të stomatologjisë

- Ofron shërbime stomatologjike;
- Avancohet dhe promovon shëndetin oral;
- Kujdeset për mjetet e punës ;
- I përmbahet etikës mjekësore;
- Kryen plotësimin adekuat të dokumentacionit;
- Bashkëpunon me ekipet e mjekësisë familjare dhe strukturat tjera relevante në përmirësimin e kujdesit oral;
- I ndihmon kolegut të sektorit të shëndetit oral;
- Kryen edhe punë tjera nga profesioni i vet. Për punën e vetë i përgjigjet shefit të sektorit oral dhe Drejtorit të QKMF-së

Numri i pozitave: kater (4)

Lloji i Pozitës: (3) infermier-e dhe (1) teknik-e të radiologjisë

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i QKMF;

Grada/Koeficienti: H 17 – 5.4 dhe H19- 5.2

Kohëzgjatja e kontratës: Në kohë të pacaktuar;

Periodha e punës provuese: Gjashtë (6) muaj.

Orët e punës: 40 në javë

Detyrat dhe përgjegjësit për infermier-e

Pranon triazhon dhe informon pacientin hap kartelën shëndetësore dhe merr anamnezën orientuese, parenteriale, i.m.i.v. subkutan, aplikon infuzionet, bënë inhalimin, përpunimin e plagës, përcjell kalendarin e imunizimit aplikon dhënien e oksigjenit, bënë audiogramet e nevojshme etj. Kryen edhe punë të tjera sipas sistematizimit të vendit të punës dhe shkollimit përkatës.

Për punën e vetë i përgjigjet kryeteknikut stafit udhëheqës dhe drejtorit të QKMF-së.

Detyrat dhe përgjegjësit për teknik të radiologjisë

- Pranon pacientët për shërbimet radiologjike, kontrollon rregullsinë e udhëzimit-mjekësor protokollon dhe evidenton të dhënat e pacientit, cakton terminin për ekzaminim;
- Kryen të gjitha procedurat e nevojshme të përgatitjes dhe pozicionimit të pacientit me qëllim të ekzaminimit;
- Përgatite aparaturën për ekzaminime dhe realizon ato sipas udhëzimeve të mjekut radiolog, përgatite komorën për përpunimin e filmave;
- Konsulton Radiologun për kualitetin e incizimit dhe cilësinë për të cilën edhe mbanë përgjegjësi;
- Është i obliguar të bartë dozimetrit personal, mjetet mbrojtëse të punës dhe i nënshtrohet matjeve të rrezatimit, vizitave të obliguara shëndetësore sistematike konform Ligjit për Mbrojtje nga Rrezatimi
- Është përgjegjës për mjetet e punës si: Kasetat, foliet, filmat, zhvilluesit, komorën automatike, racionalizimin e përdorimit të tyre dhe materialit shpenzues si dhe mirëmbajtjes së aparaturës në përgjithësi;
- Është përgjegjës për cilësinë teknike të ekzaminimit radiologjik;
- Kujdeset për mjetet e punës që disponon shërbimi radiologjik;
- Kujdeset për konfidencialitetin e pacientit;
- Është përgjegjës për evidentimin dhe kryerjen e bashkë pagesave për shërbimet e ofruara shëndetësore dhe dorëzimin e tyre në shërbimin kompetent;
- Dorëzon dozimetrat për mbikëqyrje të dozave rrezatuese në institucionin e kontraktuar nga QKMF;
- Respekton normat dhe kodin e veshjes në përputhje me Rregulloren për Uniformat Zyrtare në QKMF;
- Kryen edhe punë të tjera nga lëmia profesionale.
 - Për punën e vetë i përgjigjet kryeteknikut dhe drejtorit.

Shpallja publikohet pran Zyres për punësim në Deçan, në tabelën e shpalljeve në ambientet hyrëse pranë QKMF-s dhe në faqen zyrtare të Komunes së Deçanit.

Shpallja mbetet e hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Aplikacionet merren dhe dorzohen në zyrën juridike nga ora 7 – 15 çdo ditë pune pranë kësaj qendre.

Organi kompetent- Komisioni përzgjedhës i QKMF-s aplikon procedurat e punësimit sipas Udhëzimit administrativ të MPMS nr.07/2017 të Republikës së Kosovës.

Deçan dt.31.03.2023



DREJTORI

Dr. Selmon Berisha stom.spc i prot.

REPUBLIKA E KOSOVES MINISTRI E EDEKATIONIT DHE SHKENCES KOMUNA E DEÇAN	
NR. VET. D.	QKMF A. Ukehaxhaj 9888
NR. VET. D.	06
NR. VET. D.	31.03.23